



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 84-të të mbajtur më 30.03.2023 ka miratuar si në vijim.

## VENDIM

Denoncimi i paraqitur me numër 12-7074/1 datë 20.12.2021, me pretendimin për mosveprim dhe shpërdorim të pozitës zyrtare nga personi ----- i punësuar si inspektor në inspektoratin shtetëror të punës është HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, veprimet e denoncuar nuk janë në kompetencë të KSHPK-së për shkak se rasti në fjalë është trajtuar nga një autoritet tjetër kompetent, është kryer një inspektim gjatë të cilit nuk janë konstatuar parregullsi dhe asnjë shkelje e ligjit, që do të thotë se pretendimet e raportuara nuk janë konfirmuar.

Lënda me numër 12-7074/1 datë 20.12.2021 të mbyllet dhe arkivohet.

Ky vendim duhet të publikohet në formë të depersonalizuar në faqen e internetit të KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

## Arsyetim

Më datë 20.12.2021, një parashtrues i njohur ka bërë denoncim me pretendime për shkelje të të drejtave individuale, të cilat i referohen shkeljes së të drejtave nga marrëdhënia e punës dhe shkaktimit të dëmit personal, për çka është formuar lënda me numër 12-7074/1, datë 20.12.2021.

Në denoncim, parashtruesi pretendon për jo profesionalizëm dhe mospërfillje të detyrave të punës dhe kompetencave zyrtare në ----- nga personi inspektor ----- . Në denoncim thuhet se punonjësja nuk ka vepruar në përputhje me kompetencat e saj, ndër të tjera theksohet se në vend të gjendjes faktike të vërtetuar ka vepruar sipas veprimeve të ndërmarra nga punëdhënësi dhe avokatët e tij, me çka është shkaktuar dëm. duke cenuar një të drejtë individuale në fushën e marrëdhënies së punës.

Gjithashtu, parashtruesi i është drejtuar organit kompetent dhe ka paraqitur ankesë në Inspektoriatin Shtetëror të Punës, për shkak të dyshimit për parregullsi në fushën e marrëdhënies të punës - është zhvilluar procedura e pezullimit dhe është marrë vendim - vendim për zgjidhjen e kontratës së punës së parashtruesit . Inspektorati Shtetëror i Punës ka vepruar në bazë të një ankese të pranuar dhe në dy raste është bërë inspektim i jashtëzakonshëm tek punëdhënësi, ndërsa në procedurë nuk janë konstatuar parregullsi, por

është kryer në përputhje me Ligjin për Marrëdhëniet e Punës. Gjithashtu, parashtruesit i është vënë në dukje se nëse vazhdon të besojë se ka shkelje të të drejtave të tij të punës, mund t'i ushtrojë ato para gjykatës kompetente. Në këtë rast, parashtruesi i ankesës thekson se është dërguar ankesë në Avokatin e Popullit dhe në Këshillin Inspektues të RMV-së, nga të cilat nuk ka marrë asnjë përgjigje. Po ashtu, lidhur me rastin, parashtruesi i kërkesës ka iniciuar kontest juridik në gjykatën kompetente dhe dyshohet se për këtë ka marrë shkarkimin nga punëdhënësi.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se për rastin në fjalë ka vepruar një autoritet tjetër kompetent, është kryer një inspektim gjatë të cilit nuk janë konstatuar parregullsi dhe nuk është konstatuar shkelje e ligjit, si dhe parashtruesi i denoncimit nëse ende beson se ka shkelje të të drejtave të marrëdhënies së punës për t'iu drejtuar organit kompetent, në rastin e gjykatës civile themelore. Nga aty, KSHPK-ja ka konstatuar se në denoncim bëhet fjalë për pretendime që nuk janë objekt i veprimit të saj kompetent dhe se ato i referohen shkeljes së të drejtave individuale të parashtruesit, për të cilat ai iu drejtua organeve të tjera kompetente, pranë të cilave zhvillohet procedura ndaj rastit.

Në bazë të sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Dorëzuar:

- parashtruesi i denoncimit

Përpiloi: J.C.

Miratoi: N.B

**KOMISIONI SHETËTORËRË  
PËR PARANDAËIMIN E  
KORRUPSIONIT  
Nënkryetare,  
Katica Nikolovska**